

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: Ndërtim i shkollës së mesme “Sali Halili” 3 kat, Rrajcë Fushë,

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45214200-2, Punime ndërtimi për shkolla.

Vlera e fondit limit: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 142,631,465 (njëqind e dyzetë e dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Vlera e punimeve të ndërtimit 128,716,565 lekë pa tvsh + vlera e paisjeve 13,914,898.66 lekë(përfshihen nga tvsh)= 142,631,465 leke pa tvsh.

Vlera e punimeve të ndërtimit me tvsh :154,459,878 + 13,914,898.66 vlera e paisjeve= 168,374,778 lekë.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

c. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: 142,631,465 (njëqind e dyzet e dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa t.v.sh.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar .Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2 të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Neni 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: ".përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3. Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 45 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet , të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.
- 1.3 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4 Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 45 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.*

AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuadër të vlerësimit të ofertave në menyre sa më të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qenë pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet t’u ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotësuar sipas standartit.

AK ka kerkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", ku ndër të tjera përcaktohet se: **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**" .

Duke qënë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh (0-50%), për vlerën e kontratave te ngjashme që mund të kërkohet, njesia e prokurimit referuar percakttimeve te Nenit 39, pika 5, VKM Nr. 285, date 19.05.2021", ne te cilen përcaktohet kufiri maksimal për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, ka vendosur ta përcaktoj një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, një marzh brenda intervalit 0-50%.

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë të vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gjermimi në tokë.
- NP-2 C Ndërtime civile dhe industriale.
- NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S-2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-9 B Punime strukturore speciale.
- NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.
- NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacione
- NS-18 A Punime topogjeodezike

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër.

Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit,

projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1 A	Punime gërmimi në tokë	<i>Emërtimi i Punimeve</i>	0- 20 milion lekë Vlera e parashikuar në preventivin e punimeve 849,569.6
		<ul style="list-style-type: none"> • Gërmim dhe themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m3, shkarkimi në auto. • Gërmim e mbushje dhe me krah kat III për themele. • Gërmim dhe me krah e transport karrocë dore 10m, kat III • Hedhje, rrafshim, mbushje dhe me krah, kategoria III 	
NP-2 C	Ndërtime civile dhe industriale	Sipas kapitujve <ul style="list-style-type: none"> • Punime ndertimi dhe instalime • Punime dhe • Punime murature • Punime per shkallen e jashtme dhe shkallen e emergjences • Punime shtresash • Punime suvatime dhe veshje • Punime dritare dhe dyer • Punime bojatisje • Punime betoni dhe beton/arme • Punime hekur betoni • Punime ndertimi per palestren • Punime për sistemimin e sheshit 	51 – 100 milion lekë Vlera e punimeve e parashikuar në preventiv 99,687,101.25
NP-11 A	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Sipas kapitujve <ul style="list-style-type: none"> • Paneli elektrik kryesor • Impianti i instalimit te fuqise dhe ndriçimit • Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike + tokëzimi • Sistemi elektrik i ndricimit • Kuadri elektrik Ndricimi Infrastrukturor jashtë • Ndricimi i jashtëm 	0-20 milion lekë Vlera e parashikuar e punimeve 2,662,781.12
NP-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	<ul style="list-style-type: none"> • Preje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm • Mbushje me material te dale nga prishjet • Mbjellje bari • F.V. shkurre dekorative • F.V. Fidane Pemë dekorative • F.V. Stola gize me ristela druri 	0- 20 milion lekë Vlera e parashikuar në preventiv 2,222,550.64

NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> Punime prishje e objektit me makineri (Shkolla) 	0- 20 milion lekë Vlera e parashikuar në preventiv
NS-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	Kapitulli <ul style="list-style-type: none"> Sistemi i ujit te ngrohte sanitar 	0-20 milion lekë Vlera e parashikuar ne preventiv 2,488,531.32
NS-4 B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	<ul style="list-style-type: none"> Punime murature Punime suvatim dhe veshje Punime dritare dhe dyer Punime bojatisje 	21 – 50 milion lekë Vlera e parashikuar në preventiv 34,831,871.46
NS-9 B	Punime strukturore speciale	<ul style="list-style-type: none"> Punime Murature Punime Tarrace Punime betoni dhe beton/arme Punime hekur betoni (per godine si dhe per palestren) 	21 – 50 milion lekë Vlera e parashikuar ne preventiv 46,818,787,44
NS-12 A	Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit	<ul style="list-style-type: none"> Punimet për sistemin e ngrohjes 	0-20 milion lekë Vlera e parashikuar ne preventiv 10,652,250
NS-13 A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacione	<ul style="list-style-type: none"> Punime per linjat e internetit An 8 	0-20 milion lekë Vlera e parashikuar ne preventiv 38,250
NS-18 A	Punime topogjeodezike	<ul style="list-style-type: none"> Punime për zbatimin e rlevimeve topografik për godinës e shkollës, palestren, sheshin 	0-20 milion lekë Vlera e parashikuar ne preventiv 6,467,770.27

N.P-1A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-2 C (Ndërtime civile dhe industriale)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndërtimin e një objekti civil, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen për ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të inxhinierisë së mjedisit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-1 A (Punime për prishjen e ndertimeve)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me prishje të strukturave të betonit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-2 A (Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtja e tyre)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me impiantet hidro-termosantare si sistemi kundër zjarrit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-4 B (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e muraturës të godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-9 B (Punime strukturore speciale).

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi kemi zëra punimesh që i përkasin ndërtimit të një strukture të destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, gjithashtu e gjithë struktura beton/arme e godinave konsiderohet një strukturë e destinuar për tu vendosur mbi një zonë me parashikime të levizjeve gjeologjike pasi terreni është zone me rreshqitje referuar studimit gjeologjik, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndertimin e sistemit të ngrohjes dhe ventilimit te godinës , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacione

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi per instalimet e internetit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-18 A. Punime topogjeodezike

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndërtimin e një shkolle dhe një kopeshti dhe sistemit te territorit perفشire peisazhet dhe rrethimin, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorine N.S 18 A ku është pjesë e rëndësishme punimet topografike.

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

3. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 64 (gjashtëdhjetë e katër) punonjës të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimum për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve dhe projekt teknik (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 64 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 12 muajve kalendarike, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin

garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, sipas së cilës: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

Numri i punonjësve është përcaktuar sipas orëve të punës për çdo zë pune, volumni për ditë pune për punonjës të nevojshëm për zbatimin e projektit.

Analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. (bashkëngjitur)

4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

-Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt sipas Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

-Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik të mesiperm janë të punësuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

Për drejtuesit Teknik të kërkuar të paraqitet:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë përkatëse.

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të plotësojë pikat dhe deklaratat e mësipërme në varësi të vlerës dhe zërave të preventivit të punimeve që ka marrë përsiper sipas përqindjes së bashkëpunimit).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas DST, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar :

NP1, NP2 eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit Strukturist si person pergjegjes per punimet strukturore mbi strukturen, pra pjesa e ndertimit mbi themelin. Punimet e konstruksionit mbajtes ne objektin e ri, punimet e rrethimit metalik me lartesi deri 6m.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NS2, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit Hidroteknik per pjesen e punimeve te furnizimit me uje, te shkarkimeve etj.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NP11, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit Elektrik per pjesen e instalimeve elektrik dhe ndriçimit.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NS18, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder, pasi çdo matje, pozicionim, rakordim ne vendosje sipas plan-vendosjes që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri. Punimet e piketimit te struktureave te reja, punimet e piketimit te fushave sportive, sheshit, kuotat, kanalizimet etj.Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NP12 eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit te Mjedisit per pjesen e punimeve te shpyllezimit, te gjelberimit te hapësirave dhe te riciklimit te materialeve te dala nga prishja. Punime per mbrojtjen e mjedisit, vendgrumbullimin e materialit te dale nga germimi, uljen e nivelit te pluhurave, zhurmave Inxhinieri i mjedisit është vendosur me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit të lidhur ngushtësisht me punimeve e parashikuara në preventive.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NP2 dhe NS4 eshte e nevojshme prezenca e Arkitektit per pjesen e punimeve te rifinitures se fasades dhe sistemimin/harmonizimin e peisazhit te ambjenteve te shkolles, terreneve sportive etj.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NS12 eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit Mekanik.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknikë të shoqërisë duhet të jenë te përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

5. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b) **1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- c) **1 (një) punonjës me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *specialistin Ekspert Zjarrfikës* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidentet me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme **prania e 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.**

AK argumenton se kërkesa për **1 (një) Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë** është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për

sigurinë dhe shëndetin në punë“ , sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DT, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijeve dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjësi të pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave".

6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore apo juridike private të licensuara për këtë qëllim, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 2 (dy) Teknike ndërtimi
- 1 (një) Teknik topograf
- 1 (një) Teknik mekanik
- 3 (tre) punonjës hidraulik
- 3 (tre) punonjës elektrikist
- 3 (tre) punonjës bojaxhi
- 4 (kater) punonjës murature/suvatues
- 2 (dy) punonjës hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës karpentier
- 2 (dy) punonjës betonues
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 1 (një) punonjës specialist sisteme ngrohje/ftohje
- 1 (një) punonjës saldator
- 1 (një) punonjës hidroizoules
- 2 (dy) punonjës për punime gipsi
- 2 (dy) punonjës për punimet në lartësi
- 2 (dy) punonjës manovrator/automakanist
- 2 (dy) punonjës manovrator/ekskavatorist
- 1 (një) punonjës buldozerist
- 2 (dy) punonjës shofer
- 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës ndërtimi

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik apo institucione private të akredituara për këtë qëllim. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-së.

Në lidhje me 2 (dy) teknikë ndertimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Tekniku ndertimi do të jetë përgjegjës për zbatimin dhe mbarvajtjen e të gjithë procesit të ndërtimit të objekteve të reja, për pjesën e fushave dhe sheshit, komandimin e mjeteve dhe kantierit të ndërtimit.

1 (një) teknik topograf prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Tekniku topograf do të jetë përgjegjës për kontrollin hap pas hapi të zbatimit të punimeve të piktimit të struktureave të reja, punimet e piktimit të fushave sportive, sheshit, kuotat, kanalizimet etj.

1 (një) teknik mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Tekniku mekanik do të jetë përgjegjës për zbatimin dhe mbarvajtjen e të gjithë procesit të zbatimit sipas projektit punimeve të ngrohje-ftohje.

3 (tre) punonjës hidraulike prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Furnizimi me ujë nga rrjeti dhe Sistemi i shpërndarjes së ujit sanitar, sistemi i shkarkimit etj

3 (tre) punonjës elektrikë prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Për punimet elektrike, skemat, telat, kabllot, fuqia, ndriçimi.

3 (tre) punonjës bojaxhi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Referuar zerave të preventivit kemi lyerje me boje vaji konstruksione metalike, Lyerje mure/tavane me Boje hidroplastike (brenda), Lyerje fasade, etj

4(katër) punonjës murature/suvatues prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Referuar zerave të preventivit kemi ndërtim murature të re, suvatim muresh etj

2(dy) punonjës hekurkthyes prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike . Përpunim dhe vendosje hekuri në veper për ndërtimin e objekteve të reja.

2(dy) punonjës karpentier prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Pergatitjen dhe montimin e kallepeve për strukturat e betonit dhe b/a.

2(dy) punonjës betonues prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Pergatitjen dhe hedhjen e betonit dhe b/a.

2 (dy) punonjës pllakashtrues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Punime shtresash pllaka, veshje pllaka etj.

1 (një) punonjës specialist sisteme ngrohje/ftohje kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Punimet e sistemeve HVAC.

1 (një) punonjës saldator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Zbatim i punimeve të saldimit të konstruksioneve metalike për rrethimin e fushave dhe rrethimit perimetral të shkollës.

1 (një) punonjës hidroizolues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Punime hidro-izolimi tarace dhe ambjentëve të brendshme të godinave dhe nyjeve sanitare.

2(dy) punonjës për punimet e gipsit prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Referuar zerave të preventivit kemi punime të sistemeve të thata gipsi etj

2(dy) punonjës për punimet në lartesi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Pergatitjen dhe montimin dhe realizimi i zerave të punës që realizohen në lartesi.

2(dy) manovratore/automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Përdorimi i makinave teknologjike si auobetoniere, autopompe betoni,autobotin etj

2(dy) manovratore/ekskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Përdorimi i mjeteve të rënda si eskavator, fadrome, rula etj

1 (një) punonjës buldozerist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Përdorimi i makinave teknologjike si buldozer etj.

2 (dy) punonjës shofer kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Përdorimi i kamionave, kamionçinave etj

15(pesëmbëdhjetë) punonjës të thjeshtë ndërtimi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Punë të ndryshme fizike në ndihmë të stafit të specializuar.

6.1 Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratë individuale të punës të vlefshme;
- Diplomë që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Çertifikate e sigurimit Teknik e vlefshme, lëshuar nga institucione të autorizuar nga /ish (IQT), e cila duhet të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

6.2 Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit sipas pikës 6, emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument, numrin e certifikatës së Sigurimit Teknik si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

6.3 Për punonjësit manovrator/shofer/ buldozerist ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;

- leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. Në rastin kur punonjësit manovrator/shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

6.4 Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit manovratorë, emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e deshmisë së aftësisë profesionale si dhe afatin e vlefshmerisë .

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin ose distributorin për

a.Hekur

b.Pajisje elektrike

c.Pajisje hidraulike

d.Pajisje sistemi i ngrohjes

e.Dyer dhe dritare

f. Pajisje hidroizilimi

i. Bojra hidroplastike importi ,cilesia e pare

Në rast paraqitje kontrate me distributorin duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, ne te cilen te theksohet prodhuesi/distributori autorizon operatorin ekonomik te ofertoje ne kete procedure per produktet qe prodhon apo distribuon.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikoje qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/sherbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjejkojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si kontrata paraprake furnizimi, skeda teknike, certifikata cilesie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkesave te projektit. Plotësimi i kerkeses sipas pikes 7, garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditësuar sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- b. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 14 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

9.Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për transportim dhe riciklim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të kete kontrate shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin. Kreu II N.9 N. 12 N.24/1 N. 25, se bashku me aktin e miratimit ku minimalisht të përfshihen kodet 17 05 04 dhe 17 09 04.

Argumentim: Kriteri për licencën e lëshuar nga QKL me kodin III. 2. B është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertoje të jetë i pajisur me certifikatat e mesiperme, të lidhura me objektin e prokurimit, gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoriteti Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Në seksionin “Kategoria III.2. “ Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” , nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta (te dala nga germimi dhe prishja e objektit ekzistues), si dhe riciklimi i një pjese të mbetjeve të ngrurta (te dala nga germimi dhe prishja e objektit ekzistues) gjatë kryerjes së veprimtarisë së ndertimit.

Sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se referuar Preventivit të Punimeve, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve Transport dheu me auto, transport mbeturinash të dala nga prishjet, mbushje me material të ricikluar nga prishja e ndertimeve. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “ Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera

kryerja e veprimtarisë transporti i mbejteve inerte, transporti i dheut dhe mbushje (riciklim) i mbejteve ndertimore te dala nga prishjet e objektit ekzistues i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet te kryhet nga subjekte te licensuara dhe është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Autoriteti Kontraktor pranon edhe kontrata sherbimi me operatore te licensuar. Kerkesa per te paraqitur akt miratimin eshte bere per te verifikuar nese mbejtjet qe do te largohen apo riciklohen jane te percaktuara ne licencen e subjektit per tu administruar transportuar dhe ricikluar. Kjo kerkese ka ardhur si nje qasje e qarte e autoriteti kontraktor ndaj mbrojtjes se mjedisit, duke udhezuar per riciklimin e materialit te dale nga prishjet ne vend aty ku eshte e mundur pa cenuar qendrueshmerine e objektit ne perpjekje per te ulur impaktin dhe volumin e tij në vend depozitim duke ulur gjithashtu kostot e projektit, duke ulur demet mjedisore per nxjerrjen nga karrierat te materialeve te reja te nevojshme per mbushjet.

10. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion me kapacitet mbajtës më të madhe se 12 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet mbajtës jo me pak se 3.5 ton e jo më shumë së 12 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri 1.5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me zinxhir	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Pajisje goditesi (çekiç) për ekavator per prishje ndertimesh	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Rrul gome-hekur jo me pak se 18 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Autovinc me kapacitet mbajtes deri ne 2.5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Minifadrome	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Krik ngrites me kosh	copë	2	Në pronësi ose me qera
13	Vinc Kulle	cope	1	Në pronësi ose me qera
14	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera

17	Pajisje për prerjen, kthimin, përpunimin e hekurit	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Vibrator thellesie	copë	2	Në pronësi ose me qera
19	Vibrator sipërfaqësor	copë	2	Në pronësi ose me qera
20	Elektrosaldatriçe	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Pompë suvatimi	copë	3	Në pronësi ose me qera
22	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Armatura beton forma	m2	1500	Në pronësi ose me qera
24	Skele për suvatim	m2	2000	Në pronësi ose me qera
25	Pajisje topografike (GPS)	cope	1	Në pronësi ose me qera
26	Konteiner (zyre kantiere)	cope	1	Në pronësi ose me qera
27	Total station	cope	1	Në pronësi ose me qera
28	Impiant prodhim betoni me QKL	copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Nr.	Emri i mjetit	Proceset sipas preventivit	Sasia
1	Kamion me kapacitet mbajtës me të madh se 12 ton.	Trasport dheu të dalë nga germimet, transport mbeturinash të dalë nga prishjet për në venddepozitim, konkretisht për zerin me nr.2.37/5b, An1,3.89/b+3.158/5a etj.	2
2	Kamion me kapacitet mbajtës jo më pak 3.5 ton dhe jo më shumë se 12 ton.	Trasport dheu të dalë nga germimet, transport mbeturinash të dalë nga prishjet për në venddepozitim 2.258,2.262/1,2.300 etj	2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton	Shumica e materialeve në kantier do të sillen me kamionçina për arsye se ato garantojnë furnizimet sipas nevojave ditore, bëjnë dhe transportin e fuqisë punëtore nuk do lejohen mjete të rënda. Kapaciteti 3.5 ton sipas nevojës gjatë zbatimit të punimeve në funksion të vullmit.	1
4	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton	Shumica e materialeve në kantier do të sillen me kamionçina për arsye se ato garantojnë furnizimet sipas nevojave ditore, bëjnë dhe transportin e fuqisë punëtore nuk do lejohen mjete të rënda. Kapaciteti deri 1.5 ton sipas nevojës gjatë zbatimit të punimeve në funksion të vullmit.	2
5	Eskavator me zinxhir	Duhet për realizuar punimet për zerin me nr.2.30/a (Germim themele e plinta b~2m (punime dheu) +punime për palestren).	1

6	Pajisje goditësi (çekiç) për eskavator për prishje ndërtimesh	Pajisje teknike që i montohet eskavatorit e nevojshme për procesin e prishjes së godinës për thyerjen e strukturës nëpermjet goditjeve. Prishja e godinës ekzistuese kërkon eskavator të rende me zinxhir. Duke qene se ajo eshte godine 2 kat autoriteti kontraktor ka kerkuar qe eskavatori te jete me krahe te gjate per arsye sigurie per te garantuar qe mjeti te qendroje jashte rrezes se rrezimit te godines gjate punimeve te prishjes.Dhe per arsye se vendodhjen ku ndodhet objekti nuk ka rruge kur te kaloje eskavatori , prnadaj do te pozicionohet ne nje rruge dytesore per kryer funksionin e prishjes.Zeri me nr analize An1.	1
7	Eskavator me goma	Zëri me nr. analize 3.89/b- Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shkarkim në mjet (për sistemimin e sheshit).	1
8	Rrul gome-hekur jo më pak se 18 ton	Ngjeshjen e materialit mbushës të dalë nga prishjet e të ricikluar. Tonazhi jo më pak se 18 ton garanton thyerjen dhe kompaktësimin e këtyre mbetjeve inerte duke garantuar qëndrueshmërinë e objektit aty ku përdoren. Është i nevojshëm për kryerjen e punimeve për sistemimin e sheshit të godinës konkretisht për zërin me numër analize 3.212/c (Shtresë stabilizant t=15 cm).	1
9	Autovinc me kapacitet mbajtës deri në 2.5 ton	Ngarkim shkarkim të materialeve të ndryshme në objekt. Është i nevojshëm për kryerjen e punimeve me numër analize 2.181.	2
10	Minifadromë	Nivelime sipërfaqesore me material inert, mbushje kanalesh me material, transport i brendshëm i elementeve të ndryshme të ndërtimit si bordura pllaka trotuari etj. Është e nevojshme për të aksesuar lehtësisht në rrugë të ngushta dhe të vështira për mjetet më të mëdha. Shpërndarja e materialeve, grumbullimi i mbeturinave, apo grumbullimi i tokës.	1
11	Grejder	Është i nevojshëm për kryerjen e punimeve për sistemimin e sheshit të godinës konkretisht për zërin me numër analizë 3.212/c (Shtresë stabilizant t =15 cm).	1
12	Krik ngritës me kosh	Hidroizolim taracash, saldim konstruksionesh në lartësi, rrethim me rrjetë në lartësi etj	2
13	Vinç Kulle	Është i nevojshëm për kryerjen e punimeve, konkretisht për zërat me numër analize 2.262/1, 2.262/4, 2.267/b, 2.276 etj	1
14	Autobetoniere	Transportimin nga pika e prodhimit deri në kantjer të betonit.	2

		Autobetoniera është mjete kryesor për transportin e betonit të freskët nga impianti i prodhimit të betonit deri në vendndodhjen e ndërtesës. Kjo siguron që betoni të jetë i gatshëm për përdorim në momentin e nevojshëm, duke minimizuar humbjet dhe duke lejuar për aplikime të shpejta dhe efikase në ndërtim.	
15	Autopompe betoni	Per hedhjen e betonit ne veper ne vende dhe lartesi ku hedhje direkte nga autobetonierja eshte e pamundur	1
16	Autobot uji	Furnizimi me uje i kantierit me sasinë e nevojshme dhe në çdo kohë për proceset e punës. Është i nevojshem per kryerjen e punimeve per sistemimin e sheshit te godines konkretisht per zerin me numer analize 3.212/c (Shtresë stabilizant t =15 cm).	1
17	Pajisje për prerjen,kthimin,përpunimin e hekurit	Prerjen, kthimin dhe përpunimin e hekurit sipas vizatimeve dhe përgatitjen e tij për montim.	1
18	Vibrator thellësie	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave të ndryshme pjesë e preventivit, eshte i nevojshem per kryerjen e punimeve me numer analize 2.122/1a, 2.125/1a, 2.109/2, 2.119/1a, 2.117/1b. Përdorimi i vibratorit të thellësisë siguron që betoni të jetë i shtrirë në mënyrë të përsosur dhe të mbajë integritetin e formës dhe strukturës së përfunduar. Kjo redukton rrezikun e deformimeve ose të dobësive në beton.	2
19	Vibrator sipërfaqësor	Vibrim betoni ku ai eshte sipërfaqësor, shtrese betoni, si fusha e basketbollit etj Vibratorët sipërfaqësorë ndihmojnë në përmirësimin e forcës dhe qëndrueshmërisë së betonit në sipërfaqe, duke e bërë atë më të rezistent ndaj presioneve dhe forcave të tjera.	2
20	Elektrosaldatriçe	Saldimin ne vend te konstruksioneve metalike per rrethimin e fushave dhe rrethimin e shkollës, për realizimin e punimeve te zerit me numer analize 2.181.	1
21	Pompë suvatimi	Eshte i nevojshem per kryerjen e punimeve me numer analize 2.310.	3
22	Gazogjen	Eshte i nevojshem per realizimin e punimeve te zerit 2.181.	1

23	Armatura beton forma	<p>Armatura betoni dhe format janë të rëndësishme në ndërtimin e strukturave të betonit për disa arsye kryesore:</p> <p>1. Armatura është e nevojshme për të rritur forcën dhe rezistencën e betonit. Betoni është i fortë në kompresion (përballë sforcimeve që shtypen), por i dobët në tension (përballë sforcimeve që tërheqen). Armatura e vendosur brenda betonit ndihmon në kapjen e tensioneve dhe rritjen e rezistencës së përgjithshme të konstruksionit.</p> <p>2. Forma e betonit duhet të mbahet gjatë gjithë procesit të tharjes së tij për të siguruar që ai të mos shpërbëhet ose të deformohet për shkak të tensioneve dhe presioneve të jashtme. Armatura e vendosur në formën e betonit ndihmon në mbajtjen e integritetit të strukturës dhe formës së saj.</p> <p>3. Armatura ofron një mekanizëm të kontrolluar për të menaxhuar deformimet dhe për të lehtësuar zbatimin e ngarkesave në strukturën e betonit. Kjo përmirëson qëndrueshmërinë dhe sigurinë e përdoruesve të strukturës.</p>	1500 m ²
24	Skele per suvatim	Sherbejne per te ndihmuar specialistet dhe punetoret ne suvatimin e objektit,per zerat 2.358/b,2.117/1b,2.181,2.300,2.119/1a,2.117/1b	2000 m ²
25	Pajisje topografike (GPS)	GPS është i nevojshëm për të bërë identifikimin e koordinatave gjeografike të pikave të ndërtesës, duke përfshirë vendndodhjen e saktë të mureve, dyerve, dhe dritareve. Pëe përcaktimin e nivelit të saktë të terrenit për vendosjen e bazave dhe strukturave të ndërtesës.	1
26	Konteiner (zyre kantiere)	Sherben stafit dhe punonjesve per qendrim, pune e mbledhje pike orientuese ne object.	1
27	Total station	Eshte i nevojshem per matjen e distancave, kendeve, të matin distancat e saktë midis pikeve të ndryshme të ndërtesës dhe ambientit rrethues, pra per ndertimin e nje rrjeti infrastrukture te sakte.	1
28	Impiant prodhim beton me QKL	Impianti i betonit jep garanci autoritetit kontraktor per cilesine e betonit qe vjen ne veper nepermjet certifikates se kalibrimit, per respektimin e standarteve mjedisore nepermjet lejes mjedisore.	1

		Impiante sigurojnë që betoni të jetë i përshtatshëm për karakteristikat e nevojshme të forcës, qëndrueshmërisë. Kjo rrit efikasitetin dhe lejon për progres të shpejtë në punë. Me përdorimin e një impianti të specializuar për prodhimin e betonit, mund të kontrollohet dhe të sigurohet që betoni është i përgatitur në kushte të përshtatshme për të garantuar cilësinë.	
--	--	---	--

Kokore minimumi 64 copë

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për të trete dhe me qera (e vlefshme).

c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjisllacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në Vendim nr.216 DT 13.04.2023 "Sistemi i Itegruar i manualit te çmimeve ne Ndertim".Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

11. Operoret ekonomike duhet te paraqesin nje Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave që realizohen nga operatori ekonomik dhe që vërtetojnë se brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS

(Për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do te zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor

Unë i nënshkruari ekonomik _____fitues për kontratat.

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

- 12 Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-7:2019, SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 –1:2019, SSH EN 12390-8:2019

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas nenit 14 te ligjit Nr.8402, date 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te Ndertimit”, i ndryshuar, perkatesisht: Materialet e ndertimit te importit duhet te jene te shoqeruara me çertifikaten e cilesise nga nje laborator i akredituar nga vendet e

Bashkimit Evropian. Ne rastet kur keto materiale jane prodhuar ne vend, duhet tepajisjen me çertifikate cilesie nga laboratoret e akredituar nga Drejtoria e Standardeve dhe e Cilesise)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivi/argumentimi i nr. te punonjeseve dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projekt preventivin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij dhe te verifikuara nga specialistet e fushës nga Drejtoria e Planifikimit,Zhvillimit të Territorit / Inxhinier.

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 216 date 13.04.2023. (Bashkengjitur dosjes proceverbali i struktures të posaçme, për përlllogaritjen e fondit limit)

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve /Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialistet e fushës, anëtar te njësisë së prokurimi, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Njësia e prokurimit;